

Dr. Migena Kapllanaj ka studiuar për Punë Sociale në Universitetin e Tiranës. Ajo ka përfunduar specializimin pas universitar po në punë sociale në vitin 2008, dhe në vitin 2017 ka marrë gradën doktore e shkencave në Punë sociale me temën: "Familja shqiptare përballë sfidave të barazisë gjinore vlerësimi i nevojës për politika e shërbime". Dr. Kapllanaj ka një eksperiencë të gjatë profesionale si studiuese, pedagoge, konsulente në fushën e shkencave sociale, vlerësuese programesh etj. prej më shumë se 13 vitesh ajo punon si pedagoge, fillimisht pranë Universitetit Luigj Gurakuqi në Shkodër, Universitetit të Tiranës dhe Universitetit Marin Barleti. Gjatë viteve ajo ka dhënë mësim në lëndët metodat e kërkimit shkencor dhe analiza e të dhënave, politikë sociale, psikologji zhvillimi, sjellje organizative etj. Ajo ka marrë pjesë në një sërë konferencash brenda dhe jashtë vendit dhe ka botuar rreth çështjeve të barazisë gjinore, politikës sociale, të drejtat e fëmijëve etj. Që prej tetorit të vitit 2010 ajo është bërë pjesë gjithashtu edhe njësisë së zhvillimit të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë, fillimisht si drejtuese e njësisë së sigurimit të cilësisë për programet master e më pas si drejtuese e njësisë në nivel institucional.